

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSITË KUFIZUAR  
“TITANIUM CONSULTING” SHPK**

**AKT-THEMELIMI**

**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“TITANIUM CONSULTING” SH.P.K.**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “TITANIUM CONSULTING” Sh.p.k. dhe zoterohet nga themeluesit:

1. **TEDI PRODA**, atësia **ABAZ**, shtetas SHQIPTAR, lindur më 09/01/1992 në Vergo, me rezidencë në: rruga Vangjel Zhapa, Kodra e Shtufit, Gjirokaster, Shqipëri. Me nr kartë identiteti J20419087A.
2. **KLODIAN MUÇO**, atësia **MITAT**, shtetas SHQIPTAR, lindur më 04/11/1983 në Vergo-Sarande, me rezidencë në: Rruga studenti, nr.20 Gjirokaster, Shqipëri. Me nr kartë identiteti I31104052S

Në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “TITANIUM CONSULTING” Sh.p.k. mbi bazën e këtyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë është “TITANIUM CONSULTING” Sh.p.k.

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqërisë është në adresën: Gjirokaster, Lagjia 18-shtatori, Rruga studenti, objekti nr.20, hyrja nr.2, Shqipëri. Në adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.

**NENI 4  
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në pro:edure likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

**NENI 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**



Shoqëria " **TITANIUM CONSULTING** " Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie Shpk që merret me: konsulence; import-eksport; Aktivitet ne fushen e ofrimit te sherbimeve te ndryshme informatike; Aktivitet kerkimor, perzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivite menaxheriale dhe profesionale trajnimi. Aktivitet ne fushen e organizimit te eventeve, seminareve, takime, konferenca, organizime te pergjithshme dhe aktiviteve te promovimit te imazhit. Aktivitet ne fushen e tregtise per llogari te paleve te treta; Perdorimi i sistemeve kompjuterike ne fushen e studimit dhe kontrollit. Perdorimi i sistemeve te informacionit territorial (GIS). Shoqeria mund te marre pjese ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njejte ose te ndryshem.

Ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, ne menyre qe te arrije objektin e 2 lartpermendur, shoqeria mundet gjithashtu: Te kryeje çdo transaksion lidhur me asetet e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, si dhe aktivite te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te arritur aktivitetin e Shoqerise. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Lekë (njëqindmijë), i ndarë në 2 (dy) pjesë. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

<b>-TEDI PRODA</b>	<b>nje kuote te barabarte me</b>	<b>50% - 50.000 LEK</b>
<b>-KLODIAN MUÇO</b>	<b>nje kuote te barabarte me</b>	<b>50% - 50.000 LEK</b>

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

#### **NENI 7**

#### **AKTET E SHOQERISE**

Shoqeria do te rregullohet, pervec ketij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakut i vetëm i shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 8**

#### **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Administratori. Administratori i shoqërisë për një periudhë 4 (katër) vjeçare është themeluesi i saj Klodian Muço.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe dhe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

**Gjirokastër 05/08/2021**

**ORTAKËT E SHOQËRISË**  
**"TITANIUM CONSULTING" SH.P.K.**

**TEDI PRODA**  
**KLODIAN MUÇO**